



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Mandate, Imunitete e Rregullore të Kuvendit

Mbledhja nr. 29

16 korrik 2010, në orën 13:00 sala N-225

Ndërtesa e Kuvendit,

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Mandate, Imunitete e Rregullore të Kuvendit

Në mbledhje morën pjesë: Hydajet Hyseni - Kaloshi, Đezair Murati, Ramadan Gashi, Fatmire Berisha dhe Vladimir Todoroviq.

Munguan: Suzana Novobrdaliu, Kolë Berisha, Ahmet Isufi dhe Besa Gaxheri.

Pjesëmarrës të tjerë: Liridon Selmani - KDI; Shefki Kastrati - NDI dhe Lumnije Tafili - presidencë.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri dhe Advie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni – Kaloshi, kryetar i Komisionit.

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.06. 2010,
3. Realizimi i Planit të punës dhe plotësimi për periudhën e dytë të vitit 2010,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 30.06.2010;

Procesverbali i mbledhjes së datës 30 qershor 2010 u miratua pa vërejtje.

3. Realizimi i Planit të punës dhe plotësimi për periudhën e dytë të vitit 2010

Kryetari i Komisionit vlerësoi se shumicën e detyrave dhe aktiviteteve të përcaktuara me planin dhe programin e punës në pajtim me fushëveprimtarinë e përcaktuar, Komisioni i ka realizuar me sukses

dhe në mënyrë cilësore. Në veçanti përmendi plotësim - ndryshimin e Rregullorës së Kuvendit. Ai vlerësoi se me ndryshimin e rregullorës janë krijuar parakushte për një punë shumë më cilësore – efektive të Kuvendit e përshkruar me një frymë më të avancuar demokratike duke i krijuar mundësi të barabarta për luajtjen e rolit përfaqësues dhe vendimmarrës brenda raportit të forcave politike. Aktiviteti i Komisionit edhe më tej do jetë avancimi i cilësisë së procedurave në funksion të përmisimit dhe efektivitetit të punës parlamentare duke përvehtësuar edhe praktikën parlamentare të vendeve në rajon, e në veçanti të vendeve evropiane. Në vazhdim falënderoi anëtarët e Komisionit, partnerët e rregullt të jashtëm, si dhe stafin mbështetës të Komisionit për kontributin e dhënë në realizimin e plan - programit të Komisionit të përcaktuar për periudhën e parë të vitit. Si vështërsi në realizimin e programit përmendi konsolidimin e ngadalshëm të Komisionit, mos krijimin e kushteve të duhura për punë, si dhe ndërrimin e shpeshtë të stafit mbështetës të Komisionit.

Sa i përket plotësimit të programit të punës për periudhën e dytë të vitit theksoi se Komisioni do të jetë aktiv në parashtrimin e detyrave sipas nevojës, e në veçanti përmendi ndërmarrjen e nismës për komentimin e dispozitave të rregullorës. Ky aktivitet do jetë i përhershëm, sepse zbatimi i dispozitave të rregullores së re prej se është në fuqi shpeshherë është tejkaluar ose keqinterpretuar. Komentimi ose anashkalimi i dispozitave mund të jetë (e që do duhet gjithësesi ky komision të bëjë komente shtesë), ndoshta edhe nga paqartësia, dilemat, kolizioni, dualizmi e tjera, që mund të kenë disa dispozita. Në vazhdim ai shtoi se detyrë me prioritet, veç tjerash do jetë edhe hartimi i fjalorit parlamentar, interpretimi i instituteve juridike, bashkëpunimi i mirëfilltë me komisionet parlamentare në fushën e procedurave legjislative, ngritja përmanente e bashkëpunimit me partnerët tanë të BE - së të përfaqësuar në Kosovë, aktivitete në zbatim të planit të veprimit të kuvendit për integritet evropian, hartimin e aktit për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, aktit për procedura të komisioneve parlamentare, komentime të dispozitave të rregullores, propozime formash, si dhe metoda pune në funksion të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të punës së Kuvendit, që të gjitha në frymën e kërkesave të institucioneve përkatëse të BE - së.

Si detyrë me prioritet përmendi edhe metoda pune brenda Komisionit duke propozuar që aktiviteti të realizohet përveç në formën e zakonshme, pra në Komision, në takime tryezash, grupe punuese, nënkomisione, degjime publike, vizita brenda dhe jashta vendi, si dhe me punë individuale. Në këto forma organizimi në pajtim me rregulloren sipas nevojë do ftohen përfaqësues institucionesh, shoqatash, ekip ose individ, në cilësi ekspertësh, sipas natyrës dhe kërkesave. E mirëpresim si gjithëherë ndihmën e pakursyer të partnerëve tanë të përhershëm në mbështetje të punës sonë, si dhe të stafit mbështetës, si në aspektin teknik, ashtu edhe profesional, përfundoi Hyseni - kryetar.

Lidhur me këtë temë diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Komisionit, të cilët u pajtuan në parim me vlerësimin dhe parashikimet e prezantuara nga kryetari, dhe në vazhdim Komisioni miratoi si vijon këtë:

Përfundim

I - Plan - programi i punës së Komisionit për periudhën e parë të vitit 2010 është realizuar në tërësi dhe me sukses.

II - Për periudhën e dytë të vitit, veç parashikimeve, Komisioni do përfshijë dhe pasuroj aktivitetin e vet, përveç me tema tjera, si janë organizimi i takimeve të punës me përfaqësues të institucioneve, NDI ; OSBE- së, shoqatave, ekspertë dhe të tjerë, do bëjë hulumtime dhe shfrytëzim të praktikave të mira parlamentare të vendeve të ndryshme, do të nxjerrë aktin për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, hartimin e fjalorit parlamentar, nxjerrjen e aktit për procedurat e komisioneve, interpretimin e dispozitave, si dhe të instituteve nga rregullorja, trajtimin e rregullt të efikasitetit të

afateve, propozime dhe komente për avancim të punës së Kuvendit dhe trupave të saja, nxjerrjen e akteve të tjera, të cilat i përcakton rregullorja ose aktet e tjera më të larta në lëminë e funksionimit të Kuvendit, si dhe tema e aktivitete të tjera që mund të parashtrihen nga Komisioni ose subjekte të tjera, si kërkesa relevante dhe të nevojshme.

4. Të ndryshme:

Kryetari ndër të tjera sugjeroi që materialet që vijnë nga subjektet jashtë Kuvendit të kërkohej nga të njëjtët që t'i përkthejnë në gjuhët zyrtare, si është e përcaktuar, (sëparim - zyra për parashtrësia nuk i regjistron të pa përkthyerat) në të kundërtën preferoi që të përkthehen nga shërbimi përkatës i administratës.

Në vazhdim e ripërsëriti informatën e më hershme jo zyrtare se njëri nga deputetët gjindet në hetuesi të organeve kompetente, për të cilin Komisioni nuk ka informatë, e as kërkesë zyrtare për ta trajtuar heqjen e imunitetit të deputetit.

Ramadan Gashi, përmendi si dukuri të punës së komisioneve, stërzgjatjen e procedurës së shqyrtimit të projektligjeve, e cila në të shumtën e rasteve po tejkalohet tej mase.

Kryetari – Tha se eksperiencia disa mujore prej se ka filluar zbatimin e rregullores, gjatë seancave të Kuvendit po ndodhin pa qartësi, si dhe dilema, e shpesh herë edhe tejkalim ose anashkalim të zbatimit të rregullave procedurale. Nisur nga ky konstatim dhe përvojë, edhe pse e shkurtër (ma pak se tre muaj) ai propozoi që të hartohen disa rekomandime e propozime të cilat do t'i drejtohen Kryesisë së Kuvendit, me qëllim të ofrimit të ndihmës për respektimin dhe zbatimin sa më drejt të dispozitave të rregullores së Kuvendit.

Edhe anëtarët e tjerë e mirëpritën këtë propozim dhe u pajtuan që të hartohen rekomandime e propozime lidhur me institute, nocione e dispozita të rregullorës:

1. Për mosrespektimin e afateve gjatë procedurës legjislativë nëpër komisione (neni 57.6). Hartues - raportues: Ramadan Gashi.
2. Për institutin e votimit lidhur me dy amendamente për të njëjtën çështje (neni 58.3) raportuese - Suzana Novoberdaliu.
3. Për institutin e pyetjeve parlamentare dhe debat parlamentar hartues - raportues - kryetari i Komisionit.
4. Lidhur me ngecjet e përgjithshme në punën e Kuvendit, e në veçanti në procedimin dhe miratimin e ligjeve, bazuar në reagimet e institucionave përkatëse të BE - së hartues – raportues, Xhezair Murati.

Përfundim:

Këto rekomandime - propozime ose interpretime do shqyrtohen dhe miratohen në mbledhjen e Komisionit që do mbahet më 21. 07. 2010 dhe do i procedohen Kryesisë së Kuvendit.

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Hydajet HYSENI- KALOSHI